

L I G J
Nr.8148, datë 11.9.1996

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1578, DATË 13.8.1996 “PËR DISA
NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7599, DATË 2.9.1992 “KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8020, DATË 1.11.1995”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet me ndryshime dekreti nr.1578, datë 13.8.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7599, datë 2.9.1992 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8020, datë 1.11.1995” si vijon:

1. Në nenin 9 të dekretit, paragrafi i parë, shifra “50 000 lekë” bëhet “500 000 lekë”.
2. Në nenin 10 të dekretit hiqet fjalia “Për pikën “b” të nenit 7 efektet financiare në mbajtjen e detyrimit doganor fillojnë nga data 1 janar 1996”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1611, datë 19.9.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha